

## Paul Krecmeri

1866 - 1956

Ishte një nga indoevropianistët më të mëdhenj gjermanë. Por ne shqiptarët kemi plot arsye për të kujtuar këtë dijetar të madh. Në veprën e tij *Hyrje në historinë e gjuhës greke*, në kapitullin VII („*Fiset ilire*“) i afrohet studimit të shqipes. Aty hiqen qartë vijat e filiacionit që lidhin gjuhën tonë me ilirishten e vjetër. Si vihet në dukje përhapja e ilirëve përtej kufijve të Ilirisë së vërtetë në Greqi dhe kombësia jogreke e popullsisë së Epirit, të Akarnanisë e të Etolisë në kohën e vjetër theksohet me të drejtë kontinuiteti i elementit ilir në botën shqiptare në një sasi emrash vetjakë, që rrojnë, përkatësisht gjejnë shpjegimin e tyre në gjuhën shqipe, qofshin këta emra personash, si Bardyllis: *i bardhë*, Bata: *Batush*, qofshin emra vendesh, si Delminium Dalmatia: *delme*, Ulcinium: *ulk*, Dardania, *dardhë*, Dimallum: *mal* etj. Përcaktohen sidomos në një mënyrë përfundimtare pikat e afërisë së shqipes me ilirishten e japigëve e të mesapëve të moçëm të Italisë jugore në disa karakteristika shumë esenciale (vokale, diftongje, konsonante, leksik). Këto dy gjuhë ai i përfshin në degën dialektore të një ilirishtje jugore, ndërsa venetishtes si dialekt verior i caktohet me të drejtë një vend më i largët. Në çështjen e burimit të gjuhës shqipe Krecmeri mbron dhe përforcon mendimin e Gustav Mejerit, që thotë se shqipja paraqet fazën më të re të njërit nga dialektet e moçme ilire. Këtij mendimi ai i ndenji besnik gjer në fund, edhe në botime të mëpastajme rreth parahistorisë gjuhësore të Ballkanit.

Krecmeri edhe nëpër artikuj të ndryshëm është marrë disa herë me problemet e shqipes, në lidhje sidomos me historinë e greqishtes. Ai ka vendosur kështu afërinë e fjalës *bar* me gr. *pharmakon*, të *det - it* me *dybris*, „thalassa“, të *ditë - s* me

Titan si „hyjni i dritës“, burimin e emrit të malit *Malevos* në More nga shq. *maleve* etj.

Kreçmeri me njohuri të gjera në fushat e gjuhëve më të ndryshme dhe i pajisur me një fuqi kombinacioni jo të zakonshme, ai ka ditur të ushtrojë në anë tjetër një gjykim të mprehtë në gjithë kërkimet e tij dhe të japë një ndriçim të gjithanshëm të çështjeve që ka rrahur. Shkrimet e tij, të bazuara në një material të pasur, shquhen kështu për një gjerësi horizonti, një qartësi e një frymë objektive të rrallë. Ai mbetet një nga klasikët e gjuhësisë, një nga ata dijetarë që kanë formuar një sistem dhe që në punën e tyre kanë arritur në rezultate që do të mbeten.

### **Veprat e tij më të rëndësishme:**

1. *Die griechischen Vaseninschriften in ihrer Sprache untersucht*, Gütersloh, 1894.
2. *Einleitung in die Geschichte der griechischen Sprache*, Göttingen, 1896.
3. *Die indogermanische Sprachwissenschaft. Einwe Einführung für die Schule*, Göttingen, 1925; etj.

Marrë nga libri „**Eqrem Çabej**“ i Sh. Demiraj, botuar në Tiranë më 1990, fq. 186/190.

E përgatiti: **Agim SPAHIU**